



**MINISTRIA E DREJTËSISË**

**DREJTORIA E NDIHMËS JURIDIKE FALAS**

**ANALIZË STATISTIKORE  
NDIHMA JURIDIKE E GARANTUAR NGA SHTETI**

*Të dhëna statistikore mbi ndihmën juridike parësore dhe dytësore*

**QERSHOR 2021**

## **Botim i Drejtorisë së Ndhmës Juridike Falas**

*© Ndalohet çdo prodhim, riprodhim, shitje, rishitje, shpërndarje, kopjim, fotokopjim, përkthim, përshtatje, huapërdorje, shfrytëzim, transmetim, regjistrim, ruajtje, depozitim, përdorje dhe/ose çdo formë tjetër qarkullimi tregtar, si dhe çdo veprim cenues me çfarëdo lloj mjete apo formë*

## **Tabela e Përmbajtjes**

<b>Hyrje</b> .....	3
<b>Kreu 1:</b> Të dhëna statistikore mbi çështjet me objekt ndihmën juridike parësore.....	6
1.1 Të dhëna statistikore mbi rastet e raportuara nga qendrat e shërbimit të ndihmës juridike parësore.....	6
1.2 Të dhëna statistikore mbi rastet e raportuara nga organizatat jofitimprurëse të autorizuara.....	11
1.3 Të dhëna statistikore mbi rastet e raportuara nga Klinikat e Ligjit pranë IAL-ve.....	16
1.4 Të dhëna statistikore mbi rastet e raportuara nga platforma Juristionline dhe Numri i Gjelbër 08001010.....	18
1.5 Të dhëna statistikore mbi numrin e rasteve të raportuara nga çdo ofrues i shërbimit të ndihmës juridike parësore.....	20
<b>Kreu 2:</b> Të dhëna statistikore mbi çështjet me objekt ndihmën juridike dytësore.....	26
2.1 Të dhëna statistikore sipas kategorisë përfituese femra dhe meshkuj.....	26
2.2 Të dhëna statistikore sipas kategorisë përfituese me të ardhura dhe pasuri të pamjaftueshme ose kategori e veçantë sipas ligjit.....	27
2.3 Të dhëna statistikore sipas llojit të ndihmës dytësore të ofruar.....	27
2.4 Të dhëna statistikore sipas vendimit të Gjykatës apo organit procedues.....	28
2.5. Të dhëna statistikore sipas llojit të çështjes .....	29
2.6. Të dhëna statistikore sipas Gjykatave që kanë dhënë vendimet.....	30
2.7 Të dhëna statistikore mbi totalin e rasteve të raportuara me objekt ndihmë juridike dytësore/përfundim nga tarifat dhe shpenzimet gjyqësore...	30
<b>Konkluzione</b> .....	34
<b>SHTOJCË:</b> Ndihma juridike parësore/dytësore Janar – Qershor 2021.....	35

## **H Y R J E**

**Qëllimi i këtij punimi** është krijimi i një analize statistikore të unifikuar sa i përket sistemit të ndihmës juridike ashtu si kërkohet shprehimisht në ligjin nr. 111/2017, **“Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti”** dhe aktet nënligjore të dala në zbatim të tij e cila ndikon drejtpërdrejt në hartimin dhe zbatimin e politikave të mëtejshme në fushën e ndihmës juridike falas nga Ministri i Drejtësisë.

Referuar shkronjës “d”, neni 8 i Ligjit nr.111/2017, Drejtoria e Ndihmës Juridike, mbledh dhe analizon informacionin mbi dhënien e ndihmës juridike për të përmirësuar funksionimin e sistemit të ofrimit të ndihmës juridike dhe organizon fushata për rritjen e ndërgjegjësimit publik mbi ofrimin e ndihmës juridike dhe kushtet për përfitim të saj.

Gjithashtu, referuar shkronjës “gj”, neni 8 i Ligjit nr.111/2017, **Drejtoria e Ndihmës Juridike Falas mban, mbledh, plotëson dhe administron të dhënat e regjistrit të kërkesave dhe vetëdeklarimeve të subjekteve të këtij ligji dhe të dhënat e regjistrit të organizatave jofitimprurëse që ofrojnë ndihmë juridike parësore, sipas rregullave dhe procedurave të miratuara nga Ministri i Drejtësisë.**

Procedura e mbajtjes, mbledhjes, plotësimit si dhe administrimit të këtyre të dhënave është e përcaktuar shprehimisht në udhëzimin nr. 1, datë 08.03.2019, **“Për miratimin e rregullave dhe procedurave për mbledhjen, plotësimin dhe administrimin e të dhënave të regjistrave”.**

**Referuar këtij udhëzimi**, Drejtoria e Ndihmës Juridike Falas është organi përgjegjës për mbajtjen, mbledhjen, plotësimin dhe administrimin e:

a) Të dhënave të regjistrit të kërkesave dhe vetëdeklarimeve të subjekteve përfituese të ndihmës juridike të garantuar nga shteti.

Të dhënat e regjistrit të kërkesave dhe vetëdeklarimeve të subjekteve përfituese të ndihmës juridike të garantuar nga shteti mblidhen në bazë të kërkesës për ndihmë juridike, vetëdeklarimit dhe çdo dokumentacioni tjetër të depozituar nga kërkuesi për këtë qëllim.

Në regjistrin e kërkesave dhe vetëdeklarimeve për ndihmë juridike parësore dhe dytësore, për çdo kërkues, përfshihen të dhënat e mëposhtme:

- Kërkuesi (Emri, Mbiemri);
- Gjinia,
- Datëlindja,
- Shtetësia,
- Gjendja familjare (numri i pjesëtarëve në familje),
- Gjendja e punësimit,
- Adresa dhe të dhëna të tjera kontakti,
- Gjykata/Organi procedues pranë të cilit është dorëzuar kërkesa;
- Lloji i vetëdeklarimit;
- Lloji i ndihmës dytësore të kërkuar;
- Çështje juridike;

- Vendimi i gjykatës/organit procedues mbi kërkesën për ndihmë juridike;
- Data/Nr. i vendimit;
- Ankimim i vendimit;
- Pala ankimuese;
- Vendimi mbi ankimin;
- Avokati i caktuar;
- Pagesat e përfituara nga avokati;
- Rimbursimi i pagesave.

Udhëzimi parashikon se regjistri i kërkesave dhe vetëdeklarimeve të subjekteve përfituese mbahet në formë elektronike dhe bëhen publike nëpërmjet faqes elektronike të Drejtorisë së Ndihmës Juridike Falas në përputhje me legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale.

Regjistrat me të dhënat e plota, sipas këtij udhëzimi, mbahen pranë Drejtorisë së Ndihmës Juridike Falas. Të dhënat e plota të regjistrave u vihen në dispozicion institucioneve të drejtësisë dhe palëve të interesuara, pasi vlerësohet qëllimi i kërkesës dhe në përputhje me kriteret dhe kufizimet e parashikuara në legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale.

#### *Punonjësi i autorizuar nga Drejtoria e Ndihmës Juridike Falas*

Drejtorja e Ndihmës Juridike Falas autorizon me shkrim punonjës për plotësimin dhe përditësimin e regjistrave. Punonjësi i autorizuar është përgjegjës për saktësinë dhe përditësimin e të dhënave të hedhura prej tij.

Gjithashtu, udhëzimi parashikon se punonjësi i autorizuar nuk mund të ndërhyjë dhe të ndryshojë rubrikat e regjistrave. Në rast se bëhen gabime materiale në hedhjen e informacionit në regjistrë, punonjësi i autorizuar bën korrigjimin dhe shkruan informacionin e saktë. Regjistrat administrohen nga Drejtoria e Ndihmës Juridike Falas dhe për ruajtjen dhe asgjësimin e tyre zbatohen rregullat e parashikuara nga legjislacioni në fuqi për arkivat

## KREU I- Të dhëna statistikore mbi çështjet me objekt ndihmën juridike parësore

### 1.1 Të dhëna statistikore mbi rastet e raportuara nga qendrat e shërbimit të ndihmës juridike parësore

Referuar nenit 13 të ligjit 111/2017, Ndihma juridike parësore jepet nga: *Qendrat e shërbimit të ndihmës juridike parësore (përmes punonjësve me trajnim të posaçëm); Organizatat jofitimprurëse të autorizuar dhe Klinikat ligjore pranë institucioneve të arsimit të lartë.*

Qendrat e shërbimit të ndihmës juridike parësore janë njësi të specializuara për dhënien e ndihmës juridike parësore. Që prej hyrjes në fuqi të ligjit nr. 111/2017, Ministria e Drejtësisë dhe Drejtoria e Ndhmës Juridike Falas në bashkëpunim me partnerët ndërkombëtarë kanë patur për qëllim kryesor evidentimin dhe hapjen e qendrave të shërbimit të ndihmës juridike parësore në ato qytete ku shërbimi i ndihmës juridike falas (ofruar në mënyrë autonome nga ana e organizatave të ndryshme joqeveritare) ishte i mangët ose inekzistent por nga ana tjetër, edhe nevojat e qytetarëve për ndihmë juridike falas ishin të mëdha.

Aktualisht, gjatë periudhës Qershor 2021, Drejtoria e Ndhmës Juridike Falas administron 10 (dhjetë) qendra të shërbimit të ndihmës juridike të garantuar nga shteti si vijon:


- ❖ **Tiranë** (në bashkëpunim me OSFA në kuadër të projektit: “Qendra e Ndhmës Juridike parësore në Tiranë”<sup>1</sup>);
- ❖ **Durrës** (në bashkëpunim me UNDP në kuadër të projektit: “Mbi zgjerimin e shërbimit të ndihmës juridike parësore për gratë dhe burrat në Shqipëri”);
- ❖ **Lezhë** (në bashkëpunim me UNDP në kuadër të projektit: “Mbi zgjerimin e shërbimit të ndihmës juridike parësore për gratë dhe burrat në Shqipëri”)
- ❖ **Pogradec** (në bashkëpunim me UNDP në kuadër të projektit: “Mbi zgjerimin e shërbimit të ndihmës juridike parësore për gratë dhe burrat në Shqipëri”)
- ❖ **Lushnje** (me buxhetin e shtetit)
- ❖ **Shkodër** (në bashkëpunim me UNDP në kuadër të projektit: “Mbi zgjerimin e shërbimit të ndihmës juridike parësore për gratë dhe burrat në Shqipëri”)
- ❖ **Gjirokastrë** (në bashkëpunim me UNDP në kuadër të projektit: “Mbi zgjerimin e shërbimit të ndihmës juridike parësore për gratë dhe burrat në Shqipëri”)
- ❖ **Fier** (në bashkëpunim me UNDP në kuadër të projektit: “Mbi zgjerimin e shërbimit të ndihmës juridike parësore për gratë dhe burrat në Shqipëri”)
- ❖ **Dibër** (në bashkëpunim me UNDP në kuadër të projektit: “Mbi zgjerimin e shërbimit të ndihmës juridike parësore për gratë dhe burrat në Shqipëri”)
- ❖ **Vlorë** (në bashkëpunim me UNDP në kuadër të projektit: “Mbi zgjerimin e shërbimit të ndihmës juridike parësore për gratë dhe burrat në Shqipëri”)

<sup>1</sup> Qendra e Shërbimit të Ndhmës Juridike Parësore në Tiranë është mbështetur nga fondacioni OSFA, përmes kontratës së grantit nr. 8432, si dhe kontratës së grantit me nr. 8480, duke bërë të mundur në këtë mënyrë mbështetjen financiare të punonjësve të Qendrës Tiranë deri në muajin Prill 2021. Nga ana e Fondacionit OSFA bëhemi me dije se projekt-propozimi “*Açessible justice system*” që OSFA ka aplikuar pranë Ambasadës Holandeze në Tiranë **nuk është miratuar nga ana e kësaj të fundit, duke vënë në pikëpyetje vijuesinë e mbështetjes së qendrës së shërbimit të ndihmës juridike parësore Tiranë.** Mungesa e qendrueshmërisë sa i përket mbështetjes nga ana e Fondacionit OSFA, përbëjnë një problematikë të rëndësishme të veçantë sa i përket mirëfunksionimit të Qendrës së Shërbimit të Ndhmës Juridike Parësore Tiranë. Për këtë arsye, në kushtet kur në strukturën e institucionit të Drejtorisë së Ndhmës Juridike Falas, miratuar me urdhër nr. 59, datë 25.03.2019, të Kryeministrit, janë të përfshira 4 (katër) qendra të shërbimit të ndihmës juridike parësore dhe (tetë) punonjës me trajnim të posaçëm, **Drejtoria e Ndhmës Juridike Falas, propozoi pranë Ministrit të Drejtësisë, kalimin nën administrim të Qendrës së Shërbimit të Ndhmës Juridike Falas Tiranë, si pjesë e strukturës së Drejtorisë së Ndhmës Juridike Falas dhe pagesën e 2 (dy) punonjësve të angazhuar pranë kësaj qendre përmes fondeve të buxhetit të shtetit.**

Për muajin Qershor janë administruar 307 raste nga Qendrat e Shërbimit të Ndihmës Juridike Parësore

Qendra e Shërbimit të Ndihmës Juridike Parësore	Totali i Rasteve të raportuara	Moshë		Gjinia		Shtetësia		Kategoritë përfituese (Specifiko Kategorinë)			Natyra e Çështjes			Përkatësia Etnike	Viktima Dhune
		Mitur	Rritur	Femër	Mashkull	Shqiptar	I huaj	Të ardhura dhe pasuri të pamjaftueshme	Kategori e Veçantë	Papërcaktuar	Civile	Penale	Administrative		
<b>Tiranë</b>	<b>72</b>	-	72	36	36	72	-	20	10	42	43	9	20	-	-
<b>Lezhë</b>	<b>13</b>	-	13	8	5	13	-	3	10	-	13	-	-	-	5
<b>Durrës</b>	<b>20</b>	-	20	13	7	20	-	15	5	-	18	2	-	-	-
<b>Lushnje</b>	<b>18</b>	-	18	14	4	18	-	10	8	-	11	1	6	2	-
<b>Shkodër</b>	<b>32</b>	-	32	14	18	32	-	22	10	-	24	3	5	-	5
<b>Gjirokastrë</b>	<b>73</b>	-	73	36	37	73	-	42	31	-	33	40	-	10 romë 4 egjiptianë	-
<b>Pogradec</b>	<b>23</b>	-	23	13	10	23	-	11	12	-	12	2	9	-	-
<b>Fier</b>	<b>17</b>	-	17	9	8	17	-	13	4	-	10	2	5	3	1
<b>Dibër</b>	<b>15</b>	-	15	4	11	15	-	12	3	-	9	-	6	-	-
<b>Vlorë</b>	<b>24</b>	-	24	13	11	24	-	19	5	-	16	-	8	3 romë 1 egjiptian	1
<b>TOTALI</b>	<b>307</b>	<b>-</b>	<b>307</b>	<b>160</b>	<b>147</b>	<b>307</b>	<b>-</b>	<b>167</b>	<b>98</b>	<b>42</b>	<b>189</b>	<b>59</b>	<b>59</b>	<b>23</b>	<b>12</b>

## Rastet për muajin Qershor /Qendrat e shërbimit të ndihmës juridike parësore




■ Rastet per muajin Prill/Qendrat e shërbimit të ndihmës juridike parësore


Tiranë	Lezhë	Durrës	Lushnje	Shkodër	Gjirokastrë	Pogradec	Fier	Dibër	Vlorë
72	13	20	18	32	73	23	17	15	24




### Rastet e raportuara nga qendrat e shërbimit të ndihmës juridike parësore sipas gjinisë



### Rastet e raportuara nga qendrat e shërbimit të ndihmës juridike parësore sipas natyrës së çështjes



**Numri i subjekteve përfitues sipas kategorive  
përfituese të përcaktuara në ligj**



- Me të ardhura dhe pasuri të pamjaftueshme
- Kategori të Veçanta
- Papërcaktuar

## 1.2 Të dhëna statistikore mbi rastet e raportuara nga organizatat jofitimprurëse të autorizuara

Për muajin Qershor janë administruar 180 raste nga Organizatat Jofitimprurëse të Autorizuara si dhe 41 raste përmes linjave telefonike

OJF e Autorizuar	Totali i Rasteve	Mosha		Gjinia		Shtetësia			Kategoritë përfituese (Specifiko Kategorinë)			Natyra e çështjes		
		Mitur	Rritur	F	M	Shqiptar	I huaj	Pa shtetësi	Të ardhura dhe pasuri të pamjaftueshme	Kategori e Veçantë	Papërcaktuar	Civile	Penale	Admin
“Qendra e Këshillimit për Grat dhe Vajza” <sup>2</sup>	16	0	16	16	0	15	1	0	9	7 (viktima të dhunës në familje)	0	13	3	0
“Mbrotjtja e të drejtave të gruas qytetare dhe fshatare Berat”	5	0	5	4	1	5	0	0	0	0	5	0	0	5
“Qendra e shërbimeve dhe praktikave ligjore të integruara” <sup>3</sup>	12	0	12	4	8	12	0	0	12	0	0	6	0	6
“Intelektualët e rinj shpresë”	5	0	5	2	3	5	0	0	5	0	0	3	0	2
CRCA	15	9	6	0	15	15	0	0	0	15 (të mitur në konflikt me ligjin)	0	0	15	0

<sup>2</sup> 30 raste të trajtuara për muajin Qershor 2021, përmes linjës telefonike 116117


“Forumi i Gruas Elbasan”	9	1	8	9	0	9	0	0	0	5 (viktima të dhunës në familje)	4	9	0	0
“Shërbimi Ligjor Falas (TLAS)”	29	2	27	19	10	21	0	8	29	0	0	9	0	20
“Të ndryshëm dhe të barabartë” <sup>4</sup>	11	0	11	10	1	11	0	0	2	9 (3 viktima të trafikimit ose viktima të mundshme të trafikimit dhe 6 viktima të dhunës në familje)	0	5	3	3
“Albanian Legal and Territorial Institute (ALTRI)”	30	0	30	16	14	30	0	0	8	(14 persona përfitues nga skemat e mbrotjes sociale; 1 viktimë e dhunës në familje; dhe 7 persona me aftësi të kufizuar)	0	18	2	10
“Qendra për nisma ligjore qytetare”	39	0	39	39	0	39	0	0	17	22 (17 viktima të dhunës në familje; 3 përfitues nga skemat e mbrojtjes sociale; 2 të mitur)	0	39	0	0
“Shërbimet shqiptare për refugjatët dhe migrantët”	9	0	9	5	4	0	9	0	0	0	9	0	0	9
“Qendra Konsumatori Shqiptar” <sup>5</sup>	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-
<b>TOTAL</b>	<b>180<sup>6</sup></b>	<b>12</b>	<b>178</b>	<b>124</b>	<b>56</b>	<b>162</b>	<b>10</b>	<b>8</b>	<b>82</b>	<b>80</b>	<b>18</b>	<b>102</b>	<b>23</b>	<b>55</b>

<sup>4</sup> 11 raste të trajtuara për muajin Qershor 2021, përmes linjës telefonike.

<sup>5</sup> Nga ana e Qendrës Konsumatori Shqiptar nuk janë përcjellë të dhëna për muajin Maj dhe Qershor 2021.

<sup>6</sup> Nga 180 raste të trajtuara në total për muajin Qershor 2021, është raportuar 1 rast ku përfitues të shërbimit kanë qenë kategori Rome dhe 7 raste ku përfitues të shërbimit kanë qenë kategori Egjiptiane (**Total 8 raste**).

## Numri i rasteve të raportuara nga OJF e autorizuar



■ Series1

16

5

12

5

15

9

29

11


30

39


9

0


**Numri i rasteve të raportuara sipas natyrës së çështjes**



**Numri i rasteve të raportuara sipas gjinisë**



### Numri i subjekteve përfitues sipas kategorive të përcaktuara në ligj



■ Me të ardhura dhe pasuri të pamjaftueshme ■ Kategori të Veçanta ■ Të paidentifikuar

### **1.3 Të dhëna statistikore mbi rastet e raportuara nga Klinikat e Ligjit pranë IAL-ve**

Një ndër ofruesit e shërbimit të ndihmës juridike parësore janë edhe **Klinikat e Ligjit**. Bazuar në nenin 16 të ligjit nr. 111/2017, Drejtoria e Ndhmës Juridike Falas bashkëpunon me klinikat ligjore, sipas kushteve dhe kriterëve të parashikuara në marrëveshjet përkatëse të bashkëpunimit për trajnimin dhe përditësimin e njohurive të studentëve të përfshirë pranë këtyre klinikave, mbi çështjet e lidhura me ndihmën juridike parësore

Aktualisht Drejtoria e Ndhmës Juridike Falas ka lidhur marrëveshje me 10 Institucione të Arsimit të Lartë, në Tiranë, Durrës, Shkodër dhe Vlorë, konkretisht:

- 1. Fakulteti i Drejtësisë;**
- 2. Kolegji Universitar “Wisdom”;**
- 3. Klinika e Ligjit Shkodër (Hapur nga OSFA);**
- 4. Universiteti “Aleksandër Mojsiu” Durrës;**
- 5. Universiteti “Ismail Qemali” Vlorë;**
- 6. “Universiteti European i Tiranës”;**
- 7. “Universiteti “Qirjazi”**
- 8. Universiteti “Bedër”**
- 9. Universiteti “Mesdhetar”**
- 10. Universiteti “Marin Barleti”**

*Referuar nenit 7 të marrëveshjeve Tip të bashkëpunimit: Klinikat Ligjore do të dëgojnë të dhëna periodike çdo muaj pranë Drejtorisë së Ndhmës Juridike Falas mbi personat të cilët kanë aplikuar/përfutuar ndihmë juridike parësore. Të dhënat do të dërgohen brenda 5(pesë) ditëve të para të muajit pasardhës të muajit referues.*

Këto institucione kanë vendosur në dispozicion të qytetarëve zyra të brendshme të përshtatshme për pritjen e klientëve, të aksesueshme edhe nga persona me aftësi të kufizuar. Klinikat, referuar marrëveshjes së bashkëpunimit do të ofrojnë shërbimin e ndihmës juridike parësore sipas standardeve të përcaktuara nga Ministri i Drejtësisë dhe së bashku me qendrat e shërbimit të ndihmës juridike parësore dhe organizatat jofitimprurëse të autorizuara do të ofrojnë ndihmë juridike parësore falas për çdo subjekt përfitues sipas përcaktimeve të ligjit nr. 111/2017.



Klinikat e Ligjit	Totali i Rasteve të trajtuara	Moshë		Gjinia		Shtetësia		Kategoritë përfituese (Specifiko Kategorinë)			Natyra e Cështjes			Përkatësia Etnike	Viktima dhune
		Mitur	Rritur	Femër	Mashkull	Shqiptar	I huaj	Të ardhura dhe pasuri të pamjaftueshme	Kategori e Vecantë	Papërcaktuar	Civile	Penale	Administrative		
Kolegji Universitar Wisdom	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Universiteti Aleksandër Moisiu Durrës	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Kolegji universitar Bedër	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Kolegji Universitar Qiriazi	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Universiteti Mesdhetar	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Universiteti Europjan i Tiranës	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Fakulteti i Drejtësisë, UT	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Universiteti Ismail Qemali Vlorë	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Klinika e ligjit në Shkodër	2	0	2	1	1	2	0	2	0	0	0	0	2	0	0
Universiteti "Marin Barleti"	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
<b>TOTALI</b>	<b>2</b>	<b>0</b>	<b>2</b>	<b>1</b>	<b>1</b>	<b>2</b>	<b>0</b>	<b>2</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>2</b>	<b>0</b>	<b>0</b>

**Për muajin Qershor janë administruar 2 raste nga Klinikat e Ligjit pranë IAL-ve.**

<sup>7</sup> Klinikat e tjera nuk kanë patur raste

## 1.4 Të dhëna statistikore mbi rastet e raportuara nga platforma Juristionline dhe Numri i Gjellbër 08001010


Ministria e Drejtësisë në bashkëpunim me Fondacionin Shoqëria e Hapur për Shqipërinë, për të garantuar aksesin e qytetarëve nëpërmjet ndihmës juridike falas, ka mundur për të gjithë qytetarët ofrimin e shërbimeve ligjore online përmes **platformës juristionline.al**. Përmes kësaj platforme çdo qytetar ka mundësi të këshillohet dhe informohet lidhur me aktet normative në fuqi, të drejtat dhe detyrimet e subjekteve të ligjit dhe metodat për ushtrimin e këtyre të drejtave në procesin gjyqësor dhe në atë jashtëgjyqësor, dhënien e ndihmës në hartimin dhe përpilimin e dokumenteve të nevojshme për të vënë në lëvizje administratën shtetërore ose për të kërkuar ndihmë juridike dytësore.

Pyetjet e dërguara në këtë platformë, që nga fillimi i funksionimit të saj, kanë qenë të shumëllojëshme duke theksuar edhe njëherë nevojën që kanë patur qytetarët për një sistem të tillë i cili deri më tani figuron të jetë mjaft rezultativ sidomos në kushtet kur në vend filloi ndërmarrja e masave kufizuese si pasojë e përhapjes së infeksionit të shkaktuar nga virusi (Covid-19).


Kjo platformë ka rezultuar mjaft e suksesshme pasi vihet re një numër i konsiderueshëm qytetarësh të cilët i janë drejtuar me qëllim marrjen e një orientimi ligjor mbi problematikat e tyre edhe pas përfundimit të gjendjes së fatkeqësisë natyrore. ***Duke marrë në konsideratë natyrën e këtij shërbimi dhe duke qenë se qytetarët mund të parashtrajnë problematikën e tyre në këtë platformë thjesht përmes adresimit të një pyetjeje, pa qenë nevoja për të plotësuar të dhëna shtesë të përcaktuara në formularët për përfitim të ndihmës juridike parësore, të dhënat statistikore që mund të pasqyrojnë përkohë vetëm me natyrën e çështjes (civile/penale apo administrative)***

<b>Rastet e trajtuara Qershor 2021 (Platforma juristionline.al)</b>	
<i>Natyra e çështjeve/lloji i problematikave</i>	
<i>Rastet e lidhura me gjendjen e fatkeqësisë natyrore si pasojë e pandemisë COVID -19</i>	<b>0</b>
<b>Çështje CIVILE</b>	<b>52</b>
<b>Çështje PENALE</b>	<b>9</b>
<b>Çështje ADMINISTRATIVE</b>	<b>24</b>
<i>Kërkesë për informacione të ndryshme</i>	<b>25</b>
<i>Kërkesë për ndihmë juridike dytësore</i>	<b>0</b>
<b>TOTALI I RASTEVE TË TRAJTUARA 110</b>	

Numi i rasteve te trajtuara



Rastet e trajtuara



**- Numri i Gjelhër 08001010**

Në funksion të masave të shtuara, të ndërmarra për qytetarët që kanë nevojë për shërbime të ndihmës juridike parësore, Ministria ka vendosur në dispozicion një linjë të gjelhër në të cilën kanë akses falas të gjithë qytetarët për shërbime të ndihmës juridike. Vendosja e një numri falas është një garanci më shumë për ofrimin e shërbimeve të ndihmës juridike falas duke siguruar për qytetarët disponibilitet në çdo kohë dhe përmes disa formave. *Si platforma juristionline ashtu edhe linja e gjelhër janë masa të shtuara duke garantuar shërbime profesionale dhe me standard te lartë dhe duke qenë sa më pranë qytetarit.*


*Nga të dhënat e administruara nga Drejtoria e Ndihmës Juridike Falas rezulton se qytetarët kanë shfaqur mjaft interes në përfitimin e këtij shërbimi ligjor gjë që përbën një hap mjaft pozitiv në kuadër të garantimit të aksesit në drejtësi për qytetarët.*

*Duke marrë në konsideratë natyrën e këtij shërbimi dhe duke qenë se qytetarët mund të parashtrojnë problematikën e tyre thjesht përmes një telefonate, pa qenë nevoja për të plotësuar të dhëna shtesë të përcaktuara në formularët për përfitimin e ndihmës juridike parësore, të dhënat statistike që mund të pasqyrojnë përkojnë vetëm me natyrën e çështjes (civile/penale apo administrative).*


<b>NUMRI I RASTEVE TË TRAJTUARA (Numri i gjelber 08001010)</b>
--

<b>TOTALI I RASTEVE 53</b>
----------------------------


### 1.5 Të dhëna statistikore mbi numrin e rasteve të raportuara nga çdo ofrues i shërbimit të ndihmës juridike parësore




**Të dhëna statistikore mbi numrin e rasteve të raportuara nga çdo ofrues i shërbimit të ndihmës juridike parësore (sipas gjinisë)**



**Të dhëna statistikore mbi numrin e rasteve të trajtuara nga çdo ofrues i shërbimit të ndihmës juridike parësore  
(sipas natyrës së çështjes)**




**Të dhëna statistikore mbi numrin e rasteve të trajtuara nga çdo ofrues i shërbimit të ndihmës juridike parësore  
(sipas kategorisë përfituese)**





## Totali i rasteve të trajtuara nga ofruesit e shërbimit të ndihmës juridike parësore për muajin Qershor 2021

**652 raste**



## KREU 2: TË DHËNA STATISTIKORE MBI ÇËSHTJET ME OBJEKT NDIHMËN JURIDIKE DYTËSORE

### 1. Të dhëna statistikore: Kategoria Femra / Meshkuj.

Nga të dhënat e administruara nga DNJF gjatë muajit Qershor 2021, rezulton se nga **74 vendime gjyqësore** në total me objekt ndihmën juridike, **41** prej tyre rezultojnë kërkuese femra dhe **33** prej tyre kërkues meshkuj. Këto të dhëna paraqiten në formë tabelare si vijon:

Të Dhëna Statistikore Ndhma Juridike Dytësore QERSHOR 2021		
<i>Kategoria F/M</i>	<i>Numri i kërkuesve</i>	<i>Komente / të tjera</i>
Kërkues Femra	41	
Kërkues Meshkuj	33	
<b><u>TOTALI = 74 Vendime Gjyqësore</u></b>		

### 2. Të dhëna statistikore: Kategoria përfituese me të ardhura dhe pasuri të pamjaftueshme / kategori e veçantë.

Nga të dhënat e administruara nga DNJF gjatë muajit Qershor 2021, rezulton se nga **74 vendime** gjyqësore në total me objekt ndihmën juridike, në **56 prej tyre** kërkuesit i përkasin kategorisë së personave me pasuri dhe të ardhura të pamjaftueshme dhe në **18 vendime** kërkuesit bëjnë pjesë në kategoritë e veçanta sipas ligjit. Këto të dhëna paraqiten në formë tabelare si vijon:

Të Dhëna Statistikore Ndhma Juridike Dytësore QERSHOR 2021		
<i>Kategoria përfituese</i>	<i>Numri i Përfituesve</i>	<i>Komente / të tjera</i>
Të ardhura dhe pasuri të pamjaftueshme	56	
Viktimë dhune	5	

Kategori e veçantë  (Total 18)	<i>Person me aftësi të kufizuara</i>	13	
	<i>Përfitues nga skema e mbrojtjes sociale</i>	-	
	<i>Komuniteti Rom</i>	-	
<b><u>TOTALI = 74 Vendime Gjyqësore</u></b>			

### 3. Të dhëna statistikore: Lloji i ndihmës dytësore të ofruar.

Nga të dhënat e administruara nga DNJF gjatë muajit Qershor 2021, rezulton se nga **74 vendime** gjyqësore në total me objekt ndihmën juridike, **40** prej tyre janë kërkesa për ndihmë juridike dytësore, **30** prej tyre janë kërkesa për ndihmë juridike dytësore dhe përjashtim nga tarifat dhe shpenzimet gjyqësore dhe **4** prej tyre janë kërkesa për përjashtim nga tarifat dhe shpenzimet gjyqësore. Këto të dhëna paraqiten në formë tabelare si vijon:

<b>Të Dhëna Statistike Ndihma Juridike Dytësore QERSHOR 2021</b>		
<i>Lloji i ndihmës dytësore të ofruar</i>	<i>Numri i Përfituesve</i>	<i>Komente / të tjera</i>
Ndihmë juridike dytësore	40	
Ndihmë juridike dytësore dhe përjashtim nga tarifat dhe shpenzimet gjyqësore	30	
Përjashtim nga tarifat dhe shpenzimet gjyqësore	4	
<b><u>TOTALI = 74 Vendime Gjyqësore</u></b>		

#### 4. Të dhëna statistikore: Vendimi i Gjykatës / Organit procedues.

Nga të dhënat e administruara nga DNJF gjatë muajit Qershor 2021, nga **74 vendime gjyqësore** në total me objekt ndihmën juridike, rezulton se:

- **Janë pranuar 70 kërkesa** për ndihmë juridike dytësore dhe/ose përjashtim nga tarifat dhe shpenzimet gjyqësore;
- **Janë rrëzuar 4 kërkesa** për ndihmë juridike dytësore dhe/ose përjashtim nga tarifat dhe shpenzimet gjyqësore.

Këto të dhëna paraqiten në formë tabelare si vijon:

<b>Të Dhëna Statistikore Ndhma Juridike Dytësore QERSHOR 2021</b>		
<i>Lloji i ndihmës dytësore të ofruar</i>	<i>Numri i Përfituesve</i>	<i>Vendimi i Gjykatës / Organit Procedues Pranim/rrëzim pranim pjesërisht</i>
Ndihmë juridike dytësore	40	<b>Pranuar 37 kërkesa</b> për ndihmë juridike dytësore  <b>Rrëzuar 3 Kërkesa</b> për ndihmë juridike dytësore
Ndihmë juridike dytësore dhe përjashtim nga tarifat dhe shpenzimet gjyqësore	30	<b>Pranuar 29 kërkesa</b> për ndihmë juridike dytësore dhe përjashtim nga tarifat dhe shpenzimet gjyqësore  <b>Rrëzuar 1 Kërkesë</b> për ndihmë juridike dytësore dhe përjashtim nga tarifat dhe shpenzimet gjyqësore
Përjashtim nga tarifat dhe shpenzimet gjyqësore	4	<b>Pranuar 4 kërkesa</b> për përjashtim nga tarifat dhe shpenzimet gjyqësore
<b><u>TOTALI = 74 Vendime Gjyqësore</u></b>		

### 5. Të dhëna statistikore: Lloji i çështjes për të cilën kërkohet ndihmë juridike.

Nga të dhënat e administruara nga DNJF gjatë muajit Qershor 2021, rezulton se nga **74 vendime** gjyqësore në total me objekt ndihmën juridike, **45** prej tyre janë çështje civile; **23** vendime lidhen me zgjidhje martese; **4** vendime janë çështje penale dhe **2** çështje administrative.

Këto të dhëna paraqiten në formë tabelare si vijon:

<b>Të Dhëna Statistikore Ndhma Juridike Dytësore QERSHOR 2021</b>		
<i>Lloji i çështjes</i>	<i>Numri i Përfituesve</i>	<i>Komente / të tjera</i>
Çështje civile ( <i>pronësie, pjestim pasurie, heqje zotësie për të vepruar, vjetërsi pune, caktim kujdestarie</i> )	45	
Zgjidhje martese	23	
Penale ( <i>raste dhune</i> )	4	
Administrative	2	
<b><u>TOTALI = 74 Vendime Gjyqësore</u></b>		

### 6. Të dhëna statistikore: Gjykata që ka dhënë vendimin.


Nga të dhënat e administruara nga DNJF gjatë muajit Qershor 2021, rezulton se nga **74 vendime gjyqësore** në total me objekt ndihmën juridike, **69 prej tyre janë vendime gjyqësore** të dhëna nga Gjykatat e Rretheve Gjyqësore; **4 vendime** janë dhënë nga Gjykatat Administrative të Shkallës së Parë dhe **1 vendim** është dhënë nga Gjykata e Apelit, të ndara si më poshtë:

Këto të dhëna paraqiten në formë tabelare si vijon:


<b>Të Dhëna Statistikore Ndhma Juridike Dytësore QERSHOR 2021</b>
---

<i>Gjykata që ka dhënë vendimin me objekt ndihmën juridike</i>		<i>Numri i vendimeve gjyqësore</i>	<i>Komente / të tjera</i>
<b>Gjykata e Rrethit Gjyqësor</b>	Tiranë	13	
	Durrës	5	
	Elbasan	2	
	Fier	6	
	Gjirokastrë	2	
	Kurbin	3	
	Lezhë	9	
	Lushnje	7	
	Berat	-	
	Pogradec	2	
	Vlorë	7	
	Shkodër	7	
	Dibër	3	
	Përmet	1	
	Pukë	1	
Sarandë	1		
<b>Total = 69 Vendime gjyqësore nga Gjykatat e Rretheve Gjyqësore</b>			
<b>Gjykata Administrative e Shkallës së Parë</b>	Tiranë	3	
	Gjirokastrë	-	
	Shkodër	1	
<b>Total = 4 Vendime gjyqësore</b>			
<b>Gjykata e Apelit</b>	Korçë	1	
	Durrës	-	
<b>Total = 1 Vendime gjyqësore</b>			
<b><u>TOTALI = 74 Vendime Gjyqësore</u></b>			

**Paraqitja grafike e vendimeve gjyqësore për muajin Qershor 2021, si vijon:**



### Numri i vendimeve gjyqesore



■ Numri i vendimeve gjyqesore

21

52

63

78

64

74

■ Numri i vendimeve gjyqesore

..... Linear (Numri i vendimeve gjyqesore)



## KONKLUZIONE

### ✚ Sa i përket ndihmës juridike parësore

- ✓ Nga rastet e administruara për muajin **Qershor 2021**, në total rezultojnë **652 raste** nga të cilat **307 raste janë trajtuar nga Qendrat** e Shërbimit të Ndhmës Juridike Parësore; **180 raste janë trajtuar nga Organizatat** Jofitimprurëse të autorizuara nga Ministri i Drejtësisë; **2 raste janë trajtuar nga Klinikat e Ligjit** pranë IAL-ve; **110 raste janë trajtuar nga Platforma** juristionline.al si dhe **53 raste** janë trajtuar përmes numrit të gjelbër 08001010.
- ✓ Nga analiza e këtyre të dhënave, në krahasim me muajin Prill dhe Maj 2021, **konstatohet një rënie e lehtë e rasteve të trajtuara** nga 711 raste në Prill, në 679 raste në muajin Maj, në 652 raste në muajin Qershor (*konstatohet një rritje e numrit të rasteve nga Qendrat ndërsa Klinikat, Organizatat, platforma juristionline dhe numri i gjelbër kanë pësuar një ulje të numrit të rasteve të trajtuara në krahasim me muajin Maj 2021*);
- ✓ **Qendrat e shërbimit të ndihmës juridike parësore vijnë rritjen e numrit të rasteve të trajtuara në krahasim me Organizatat Jofitimprurëse të Autorizuara.**
- ✓ Vlen të evidentohet performanca e Qendrave të Shërbimit të Ndhmës Juridike Parësore në **Tiranë, Shkodër dhe Gjirokastrë** ndërsa qendra që ka më shumë nevojë për promovim me qëllim shtimin e numrit të rasteve të trajtuara është Qendra e **Dibrës**;
- ✓ Sa i përket organizatave jofitimprurëse të autorizuara, **organizatat me numrin më të lartë të rasteve të trajtuara vijnë të mbeten: Qendra për Nisma Ligjore Qytetare; ALTRI dhe TLAS** ndërsa Qendra Konsumatori Shqiptar vijon të mos përcjellë raste që prej muajit Maj 2021.
- ✓ **Problematikë vijon të mbetet numri shumë i ulët i rasteve të trajtuara nga 10 (dhjetë) Klinikat e Ligjit pranë IAL-ve** të cilat përgjatë këtij muaji kanë trajtuar vetëm 2 raste. Kjo lidhet dhe me faktin që Fakultetet ku operojnë këto Klinika janë mbyllur si pasojë e mbylljes së vitit akademik.
- ✓ Fokus shumë i madh po i kushtohet grupeve dhe kategorive vulnerabël dhe në këtë kuadër, nga analiza e të dhënave të muajit Qershor 2021, konstatohet se ofruesit e shërbimit të ndihmës juridike parësore kanë trajtuar një numër të konsiderueshëm të rasteve ku përfitues janë kategoritë e veçanta. Gjithashtu, vëmendje e veçantë i është kushtuar personave në pamundësi financiare, kategori e cila përbën mbi 51 % të rasteve të trajtuara për këtë muaj.
- ✓ **Vihet re një numër i ulët rastesh kur përfitues kanë qenë të miturit apo personat që i përkasin kategorive rome apo egjiptiane.** Si rrjedhojë, nevojitet një vëmendje e shtuar përmes zhvillimit të aktiviteteve ndërjegjësuere të dedikuara për këto kategori.
- ✓ Së fundmi, sa i përket mënyrës së raportimit të të dhënave konform udhëzimit nr. 1/2019, të Ministrisë të Drejtësisë, **vihet re se disa nga ofruesit vijnë të mos përcjellin të dhënat sipas formatit të kërkuar** (*duke mos specifikuar kategoritë e veçanta përfituese të ligjit*)<sup>8</sup>. Lidhur me këtë problematikë, i bëjmë thirrje ofruesve të respektojnë elementët e përcaktuar në udhëzimin nr.1, datë 08.03.2019, “Për miratimin e rregullave dhe procedurave për mbledhjen, plotësimin dhe administrimin e të dhënave të regjistrave”.

<sup>8</sup> Qendra e Shërbimit të Ndhmës Juridike Parësore Tiranë; Dibër; Shoqata Mbrojtja e të Drejtave të Gruas Urbane dhe Rurale Berat si dhe Shoqata “Shërbimet Shqiptare për Refugjatët dhe Migrantët”.

## **Sa i përket ndihmës juridike dytësore**

- ✓ Nga vendimet gjyqësore me objekt ndihmën juridike falas, të administruara nga DNJF për muajin **Qershor 2021, në total rezultojnë 74 vendime** gjyqësore nga të cilat në **70 vendime janë pranuar** kërkesat për ndihmë juridike dhe/ose përjashtim nga tarifat dhe shpenzimet gjyqësore dhe në **4 vendime janë rrëzuar** kërkesat për ndihmë juridike dytësore për mos plotësim dokumentacioni/ mospërmbushje të kriterëve të ligjit.
- ✓ **Nga analiza e këtyre të dhënave**, në krahasim me muajin Maj 2021, **konstatohet një rritje e kërkesave për ndihmë juridike dytësore**, me një numër prej 10 vendimesh më shumë se në muajin Maj (*për muajin Maj janë administruar 64 vendime gjyqësore*).
- ✓ **Një arritje** gjatë kësaj periudhe lidhet me kategorinë përfituese nga shërbimi i ndihmës juridike, numrin më të madh të të cilëve e përbën gjinia femërore. (*41 përfitues femra dhe 33 përfitues meshkuj*).
- ✓ **Fokus dhe vëmendje e veçantë** i është kushtuar kategorive vulnerabël. Nga të dhënat rezulton se kemi një rritje kërkesash nga personat me aftësi të kufizuar dhe viktimat e dhunës në familje.
- ✓ Numrin më të madh të vendimeve e përbëjnë çështjet civile të kryesuara nga çështjet e pronësisë dhe çështjet familjare (zgjidhje martesë).
- ✓ **Lidhur me Gjykatat që kanë dhënë vendimet me objekt ndihmën juridike** dytësore dhe / ose përjashtim nga tarifat dhe shpenzimet gjyqësore, rezulton se: për muajin Qershor 2021, **numrin më të madh të vendimeve e ka dhënë Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë**, e pasuar nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Lezhë, Vlorë, Shkodër dhe Lushnjë. Kjo e dhënë reflekton jo vetëm nevojat e qytetarëve për të përfituar nga ky shërbim por lidhet edhe me faktin e ndërjegjësimit / informimit të qytetarëve në këto qytete.
- ✓ **Fokusi për muajt në vijimësi** duhet të përqëndrohet tek ato qytete në të cilat kemi një numër shumë të ulët të kërkesave për ndihmë juridike dytësore dhe / ose përjashtim nga tarifat dhe shpenzimet gjyqësore si dhe tek ato qytete ku nuk ka fare kërkesa për ndihmë dytësore.

## SHTOJCË 1

### NDIHMA JURIDIKE PARËSORE JANAR- QERSHOR 2021

<b>Qendrat e Shërbimit të Ndhmës Juridike Parësore</b>
<b>Totali i rasteve të raportuara: 1429</b>

<b>Organizatat jofitimprurëse të autorizuara</b>
<b>Totali i rasteve të raportuara: 1249</b>

<b>Platforma juristonline.al/ Numri i gjelbër</b>
<b>Totali i rasteve të raportuara: 1348</b>

<b>Klinikat e Ligjit pranë IAL-ve</b>
<b>Totali i rasteve të raportuara: 29</b>

**Total Ndhima Juridike Parësore: 4055 raste**

### NDIHMA JURIDIKE DYTËSORE JANAR- QERSHOR 2021

<b>Vendime Gjyqësore me Objekt Ndhmën Juridike</b>						
<b>JANAR – QERSHOR 2021</b>						
<i>Pranim të kërkesës për ndihmë juridike dytësore</i>	<i>Rrëzim të kërkesës për ndihmë juridike dytësore</i>	<i>Pranim të kërkesës për përjashtim nga taksat dhe shpenzimet gjyqësore</i>	<i>Rrëzim të kërkesës për përjashtim nga taksat dhe shpenzimet gjyqësore</i>	<i>Pranim të kërkesës për ndihmë juridike dytësore dhe kërkesës për përjashtim nga taksat dhe shpenzimet gjyqësore</i>	<i>Rrëzim të kërkesës për ndihmë juridike dytësore dhe kërkesës për përjashtim nga taksat dhe shpenzimet gjyqësore</i>	<i>Kthim aktesh/pushim cështjeje/cështje në gjykim/moskompetencë/</i>
<b>157</b>	<b>14</b>	<b>37</b>	<b>1</b>	<b>140</b>	<b>2</b>	<b>1</b>
<b>Totali i Vendimeve Gjyqësore = 352</b>						